

Raport nga Kampi veror për të rriturit me aftësi të kufizuara, (aftësi të ndryshme të kufizuara) Grupi i tretë (III) "Ulqini 2007"

Prej datës: 31 gusht deri më 11 shtator 2007



Përkrahur dhe financuar nga: ROBERTO BAZZONI ONLUS
Organizuar nga: HANDIKOS-i

Personeli:

Përgjegjës i Kampit: Jakup Vitia

Asistent i përgjegjësit: Sadat Gashi

Teknik mjekësor: Muharrem Ceji

Pjesëmarrësit në grupin e tretë: 50 persona

Për dallim nga grupi i parë i cili përbëhej nga fëmijët, grupi i dytë i cili përbëhej nga personat me lëndime të palcës kurrizore, në grupin e tretë pjesëmarrja e anëtarëve të grupit ka qenë e përbërë nga personat me aftësi të kufizuara, por të ndryshme dhe është përbërë edhe nga anëtarët e tri (3) shoqatave tjera.

Struktura e pjesëmarrësve sipas nivelit të aftësisë së kufizuar ka qenë kjo:

Nga shoqata e të verbërve - 3 anëtarë,

Nga shoqata e të shurdhërve - 3 anëtarë,

Nga Klubi "Dëshira" me aftësi të kufizuara mendore - 4 anëtarë,

Me aftësi të ndryshme të kufizuara - 30 veta

Shoqërues - (përcjellës) 7 vetë

Personeli – 3 veta

Udhëtimi

Udhëtimi nga Prishtina për në Ulqin u bë me Autobusë të Kompanisë "Lindi Tours", sikurse edhe për grupet tjera. Transporti ishte mjaft komod dhe gjatë rrugës kaluam shumë mirë, udhëtimi la mbresa tek të gjithë anëtarët, ishte një udhëtim i rahatshëm, i qetë dhe shoqërues, nga një herë edhe kemi kënduar ndonjë këngë, pasi që të gjithë ndiheshim të gëzuar dhe të lumtur.



Dita e parë

Në mbrëmjen e ditës së parë pasi që e krijuam rrethin në parkun e Hotelit, filloi prezantimi e të gjithë pjesëmarrësve duke u dhënë fjalën të gjithëve.

Afrim Maliqi – Menaxher i Handikosit dhe përgjegjës për Kampin Ulqini 2007, duke na shprehur mirëseardhje filloi të prezantojë qëllimin e Kampit, disa rregulla të mirësjelljes si dhe një prezantim të historikut të donatorit të Kampit ONLUS R. BAZZONI e po ashtu edhe orarin e aktiviteteve.

Më pas pjesëmarrësve ju ofruan maicat me mbishkrimet e HANDIKOS-it dhe ROBERTO BAZZONI-it, në mënyrë që dukja e



pjesëmarrësve të jetë sa më e mirë, si një uniformë e cila për grupin kanë qenë shumë të dashura dhe të respektuara për mbishkrimet që kanë mbajtur në to, si dhe pjesëmarrësve ju shpërndanë edhe nga një shumë e të hollave.

Aktivitetet fizike - Gjimnastika

Për çdo mëngjes sa zgjati Kampi anëtarët e grupit janë zgjuar në kohë dhe me kohë të caktuar duke qenë të gjithë të gatshëm për aktivitetet e ditës të cilat i mbanim, Mëngjesin e fillonim prej orës 8:30 deri në ora 9:00, ndërsa gjimnastikën e mëngjesit e fillonim prej orës 9:00 deri në ora 10:00, pasi që Hoteli në të cilin ishim të vendosur dispononte me fusha sportive ne ishim shumë të kënaqur për këtë dhe kishim mundësi t'i shfrytëzojmë ato me anëtarët e grupit duke mos humbur asnjë moment vetëm e vetëm që të arrihet rezultati tek personat me aftësi të kufizuar. Ushtrimet i fillonim duke i kaluar nga njëri tek tjetri gjatë ditës në mënyrë që edhe ata të arrijnë që të jenë si instruktorë sportivë, e cila ishte një ndjenë shumë e mirë dhe qëllimi ishte që të gjithë të ishim aktivë në ushtrime.

Plazhi dhe aktivitetet sportive

Në plazh kemi organizuar hyrjen në ujë të anëtarëve duke vlerësuar se çfarë lojërash mund të kemi edhe në ujë, si dhe duke krijuar lidhje më të fortë mes atyre që e njohin notin dhe atyre që nuk e njohnin këtë sport dhe kështu ia arritëm që edhe ata që filluan tani të mësojnë në lidhje me notin duke filluar nga frymëmarrja para se të fusin kokën në ujë, dhe realizuam edhe lojëra me top në ujë.



Pastaj në plazh organizuam

edhe lojëra tjera sportive si: futboll, volejball etj, si dhe disa ushtrime të cilat ishin të rëndësishme për ta. Është me rëndësi të përmendet se të gjithë personat tregonte interesim të madh çdo aktivitet që e paraqiteshim dhe ata vetë u angazhonin që të vazhdojmë edhe më tutje me ushtrime, notim dhe lojëra tjera.

Dreka

Pas plazhit dhe aktiviteteve të ndryshme, arrinte koha e drekës dhe të gjithë nga Plazhi arrinim në kohë të caktuar për të ngrënë drekë. Gjatë drekës drekonim gjithnjë me anëtarët e ndryshëm në mënyrë që të gjithë të jemi më të afërt dhe të kemi një pasqyrë të qartë se si po kalojnë në Kamp, çfarë idesh mund të kenë për të ardhmen por jo duke u bërë pyetje por bisedë të lirë në mënyrë që të ndihen sa më të lirë dhe më të shoqërueshëm.



Pas drekës të gjithë ishim në Plazh duke vepruar me aktivitetet që i përmendëm më lartë pra sikur ato para dreke.

Seancat

Për çdo ditë pas orës 18:30 në oborrin e hotelit janë mbajtur seanca të hapura dhe diskutime të ndryshme që kishin të bënin me vetë anëtarin që kishte dëshirë për tu shprehur për vetveten rreth jetës, rreth të gjitha gjërave që kanë vështirësi.

Këto diskutime kishin të bënin me gjetjen e mënyrave më të mira për tejkalimin e vështirësive që personat me aftësi të kufizuar kishin në sfera të ndryshme të jetës të jetës së tyre, si: paragjykimet, komplekset e ndryshme, barrierat fizike dhe në veçanti realizimin e të drejtave të tyre si çdo qytetar tjetër.

Interesime kishte rreth ndjekjes së kurseve të ndryshme, mundësisë së shkollimit, përfitimit të bursave për shkollim, krijimin e ndonjë vendi të punës për punësimin e tyre, transportit deri në shkollë dhe anasjelltas,



interesim zgjonte edhe Programi i rehabilitimi i bazuar në Bashkësi të cilat shërbime i ofron HandiKOS-i, krijimin e mundësive për rregullimin e disa protezave, organizimin edhe të ndonjë kampi edhe gjatë stinëve të tjera nëpër Kosovë. Gjithashtu mjaft u bisedua edhe për ligjet e aplikueshme në Kosovë që kanë të bëjnë me personat me aftësi të kufizuar, nga të cilat disa nuk i plotësojnë nevojat e personave me aftësi të kufizuar. Pjesëmarrja në këto seanca ka qenë shumë aktive.

Mbrëmjet- çdo mbrëmje janë organizuar aktivitete të ndryshme sportive por edhe aktivitete rekreative si: shah, ping-pong, letra dhe ndonjë aktivitet tjetër që inicionin ndonjë prej anëtarëve të grupit.

Kuizi i Diturisë

Gjatë një mbrëmje pas seancës vendosëm të mbajmë një Kuiz të Diturisë të cilin e përgatitëm prej disa pyetjeve që janë të nevojshme të dinë anëtarët e grupit dhe vendosëm pyetje nga shkenca të ndryshme. Pjesëmarrësit i kemi ndarë në dy grupe, Grupi A dhe Grupi B por gjithashtu edhe jurinë.

Kuizi ishte shumë i pranuar tek të gjithë anëtarët dhe ishin të koncentruar në mënyrë që të përgjigjeshin sa më mirë që ishte e mundur. Moderatorin krijoi atmosferë shumë të mirë gjatë tërë kuizit duke u dhënë fjalën të gjithë atyre që ishin të gatshëm të përgjigjen, por edhe nëse nuk kishin përgjigje të sakta ata ishin të kënaqur me

pjesëmarrjen duke u munduar që të gjejnë përgjigjen konkrete. Në fund u llogaritën poenët të cilët ishin përafërsisht të afërt dhe Juria pasi numëroi poenët vendosi që rezultati të shpallet dhe ai ishte i barabartë. Kuizi ishte shumë i pëlqyer nga të gjithë pjesëmarrësit.

Dalja në qytet dhe rekreacioni:

Shëtitja në qytet është bërë gjatë mbrëmjeve në grupe më të vogla, si dhe dy herë komplet grupi në mënyrë të organizuar, çka ishte shumë e rëndësishme për pjesëmarrësit. Dalja në qytet e kishte efektin pozitiv të të gjithë meqenëse shumë prej tyre ishin nga viset rurale dhe si gjithmonë të izoluar dhe të mbyllur nëpër shtëpi.

Kujdesi shëndetësor:

Sikur edhe çdo vit, edhe në këtë kamp ka qenë i angazhuar tekniku mjekësor i cili është kujdesur për të gjithë ata që kanë pasur nevojë mjekësore.

Gjatë kohës së kampit ka pasur disa intervenime të cilat nuk ishin të rënda. Te disa anëtarë nganjëherë kishte kokë dhimbje, etj. por në përgjithësi niveli i shëndetit tek të gjithë anëtarët ishte i mirë si dhe nuk munguan pajisjet mjekësore të cilat i kishim sjellur me vete.

Ahengu-party

Me iniciativën e disa prej anëtarëve të grupit u ndie nevoja që të organizojmë një mbrëmje shoqërore e cila ishte mbrëmja edhe përshëndetëse për tërë grupin.

Pas gjithë atyre ditëve të lumtura në një shoqëri shumë të afërt dhe me plot aktivitete, ishte mjaft e vështirë ndarja pasi që vërtet grupi krijoi lidhshmërinë shumë të mirë mes njëri tjetrit në përgjithësi sikur të ishim një familje.



Gjatë mbrëmjes organizuam edhe një zgjedhje të Misit dhe Misterit të Mbrëmjes që u pëlqye nga të gjithë, përveç muzikës, vallëzimit kishte edhe humor.

Udhëtimi për në Kosovë

Pas gjithë këtyre ditëve të lumtura e të hareshme për tërë grupin erdhi edhe mbrëmja kur ne duhet të niseshim për në Prishtinë. Rrugëtimi prej Ulqini në Kosovë ishte në nivelim më të mirë të mundshëm, dhe ishte një gëzim por edhe një pikëllim. Gëzimi ishte që të gjithë po ktheheshim në familje pas asaj që kaluam gjatë kampit dhe pikëllimi ishte se ndaheshim nga njëri tjetri duke i shtrënguar duart dhe përqaftuar duke u shprehur se do të shihemi edhe në të ardhmen.



Falënderim nga Grupi i Tretë III
Grupi i Tretë falënderon përzemërsisht organizatorin donatorin ONLUS R. BAZZON dhe e përgëzon për organizimin aq të mirë dhe të suksesshëm të Ju falënderojmë për përkrahjen, dhe ju përgëzojmë për punën që po bëni, Stafi dhe Anëtarët e Grupit të Tretë të Kampit Ulqini 2007.



Përgjegjës i Kampit: Jakup Vitia
Asistent i përgjegjësit: Sadat Gashi
Teknik mjekësor: Muharrem Ceji